



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. P3.P/ Prot
2

Tiranë më 26.4. 2018

VENDIM

Nr. 11 datë 26.04 2018

“Për miratimin e planit të kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)”

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në vendimin nr. 24, datë 20.11.2017 të Senatit Akadcmik “Për miratimin e Planit të Veprimit me qëllim përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të të gjitha rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, datë 21.09.2017”, Senati Akademik pasi shqyrtoi Draft-Raportin e paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 3, datë 22.02.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës”, në mbledhjen e datës 26.04.2018:

VENDOSI

1. Miratimin e planit të kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022) bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)

Miratuar me Vendim nr. 11, datë 26.04.2018
të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës

Tiranë, Prill, 2018



Përmbajtja

Listë e Shkurtesave	
1. Shkurtimisht mbi Universitetin e Tiranës	4
2. Misioni dhe Vizioni i UT-së.....	8
3. Parimet mbi të cilat është i mbështetur Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor (PSKSH) në UT	10
4. Qëllimi i hartimit të PSKSH-së.....	13
5. Objektivat kryesorë të kërkimit shkencor në Universitetin e Tiranës.....	13
6. Plani i veprimit	14
Matricë e Planit të Veprimit të PSKSH-së të Universitetit të Tiranës.....	25
7. Financimi i PSKSH.....	42
8. Vlerësimi, monitorimi, raportimi dhe rishikimi i PSKSH.....	42

Listë e Shkurtesave

BA	Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DI	Drejtoria e Informacionit
DJ	Drejtoria Juridike
DK	Drejtoria e Komunikimit
FE	Fakulteti i Ekonomisë
FGJH	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
FHF	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
FD	Fakulteti i Drejtësisë
FSHS	Fakulteti i Shkencave Sociale
FSHN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
HEK/ERA	Hapësira Evropiane për Kërkim (ERA)
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
ISE	Instituti i Studimeve Europiane
KE	Komiteti i Etikës
KEKSH	Karta Evropiane e Kërkimit Shkencor
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
QKFF	Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës
QZHK	Qendrat e Zhvillimit të Karrierës
SA	Senati Akademik i Universitetit të Tiranës
SKKSHTI	Strategjia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (2017-2022)
UT	Universiteti i Tiranës





1. Shkurtimisht mbi Universitetin e Tiranës

Universiteti i Tiranës u themelua në vitin 1957 dhe kishte në përbërjen 6 fakultete. Në këtë institucion u shkri në Institutin Pedagogjik, Politeknik, Ekonomik, Mjekësor, Juridik dhe Institutin e Shkencave. Në vitin 1967 universiteti mori formën e vetë të plotë me ndërtimin e kampusit të parë të saj duke i dhënë këtij universiteti një dinamizëm më të madh. Kështu pas 22 viteve nga krijimi në vitin 1977 numri i studentëve pa shkëputje nga puna arriti në 8880, nga të cilat rreth gjysma ishin vajza. Duhet theksuar që në këto vite të para ishin diplomuar 21368 studentë të cilët më pas u angazhuan në sektorët më të vështirë të jetës së vendit. Nuk kishte si të mos ndikonin në eksperiencën e universitetit studentët që studionin në disa nga universitetet më të mirë të kohës si në Ish-Bashkimin Sovjetik, Hungari, Francë, Suedi, Gjermani, Itali, etj.

Universiteti i Tiranës sot

Universiteti i Tiranës (UT) është universiteti më i madh publik në vend. Ai veçohet ndër gjithë universitetet e tjera publike dhe private, për sasinë, larminë, veçantinë e fakulteteve, degëve, drejtimeve, profileve të studimit, të specializimit dhe të kualifikimit. UT aktualisht është i përbërë nga 6 fakultete (njësi kryesore), 2 institute kërkim-zhvillimi (njësi kryesore), 1 departament për sportet në varësi të UT (njësi e veçantë ndër fakultetore), Institutin "Konfucij" në varësi të UT (njësi e veçantë), si dhe Filiali në Sarandë (njësi të veçanta në varësi të UT). Secili fakultet ka në përbërje jo më pak se 3 departamente (njësi bazë). Filiali i Sarandës është i ndarë në dy njësi bazë (gjuhës angleze dhe administrimit të biznesit).

Një nga qëllimet e Universitetit të Tiranës është njohja e tij ndërkombëtare. UT-ja është institucion partner në disa programe bashkëpunimi të Komisionit Europian si Tempus, Erasmus Mundus Action 2, IPA, më konkretisht: JoinEU-SEE, Basiliscus, Pacinno, Eureka, Tempus Interface. Nga projektet e mobilitetit ERASMUS + kanë përfunduar të gjitha strukturat e UT-së, studentët, stafi akademik dhe ai administrativ.

UT ka nënshkruar edhe shumë marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione të ndryshme evropiane dhe botërore. Këto marrëveshje kuadër kanë si qëllim shkëmbimin akademik dhe studentor, programe kërkimi të përbashkëta, shkëmbime akademike në botime, revista, organizimin e konferencave të ndryshme etj. Ai gjithashtu është anëtar i shumë rrjeteve të huaja si: AUF, UNICA, UNIMED, CMU etj.

Në vitin akademik 2017-2018, stafi akademik me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës përbëhet nga 740 anëtarë, i organizuar sipas njësisve të tij kryesore dhe bazë si më poshtë.



Fakulteti i Drejtësisë (FD) ka tre departamente: Departamenti i të Drejtës Civile (13 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 10 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i të Drejtës Penale (12 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 7 me gradë shkencore dhe 2 master) dhe Departamenti i të Drejtës Publike (11 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 12 me gradë shkencore dhe 3 master).

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka 8 departamente dhe 1 qendër: Departamenti i Kimisë (16 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 10 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Biologjisë (16 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 8 me gradë shkencore dhe 2 master); Departamenti i Bioteknologjisë (6 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 1 me gradë shkencore dhe 3 master); Departamenti i Fizikës (ka 9 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 6 me gradë shkencore dhe 8 master); Departamenti i Matematikës (7 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 8 me gradë shkencore dhe 3 master); Departamenti i Kimisë Industriale (8 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 6 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Matematikës së Aplikuar (5 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 7 me gradë shkencore dhe 5 master); Departamenti i Informatikës (3 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 9 me gradë shkencore dhe 14 master); Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës (5 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 4 me gradë shkencore dhe 4 master).

Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS) ka 5 departamente; Departamenti i Filozofisë (2 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 6 me gradë shkencore); Departamenti i Shkencave Politike (3 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 10 me gradë shkencore); Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë (8 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 17 me gradë shkencore); Departamenti i Politikave dhe Punës Sociale (14 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 8 anëtarë me gradë shkencore); Departamenti i Sociologjisë (4 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 6 me gradë shkencore dhe 2 master).

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (FHF) ka 6 departamente, Departamenti i Historisë (10 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 3 me gradë shkencore dhe 3 master), Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit (3 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 7 me gradë shkencore dhe 5 master), Departamenti i Letërsisë (10 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 8 me gradë shkencore); Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (3 anëtarë personel

akademik të kategorisë profesor, 1 me gradë shkencore dhe 3 me master); Departamenti i Gjeografisë (12 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 8 me gradë shkencore), Departamenti i Gjuhës (13 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 3 me gradë shkencore dhe 2 Master).



Fakulteti i Ekonomisë (FE) ka 6 departamente; Departamenti i Ekonomisë (17 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 12 me gradë shkencore dhe 6 master); Departamenti i Menaxhimit (12 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 10 me gradë shkencore dhe 8 master); Departamenti i Financës (12 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 10 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Kontabilitetit (7 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 5 me gradë shkencore dhe 7 master); Departamenti i Marketing-Turizmit (10 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 4 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (14 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 7 me gradë shkencore dhe 5 master).

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH) ka 6 departamente; Departamenti i Gjuhës Angleze (10 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 33 me gradë shkencore dhe 8 master); Departamenti i Gjuhëve Slavo-Balkanike (ka 10 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 4 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Gjuhës Spanjolle (1 anëtar personel akademik të kategorisë profesor, 6 me gradë shkencore dhe 2 master); Departamenti i Gjuhës Italiane (9 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 12 me gradë shkencore dhe 4 master); Departamenti i Gjuhës Franceze (13 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 9 me gradë shkencore dhe 2 master); Departamenti i Gjuhës Gjermane (1 anëtar personel akademik të kategorisë profesor, 12 me gradë shkencore dhe 4 master);

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ) ka tre departamente: Departamenti i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe Rrjeteve të monitorimit (3 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 3 me gradë shkencore dhe 1 master); Departamenti i Radiometrisë e Radiokimisë (2 anëtar personel akademik të kategorisë profesor, 5 me gradë shkencore); Departamenti i Metodave Analitike Instrumentale (2 anëtarë personel akademik të kategorisë profesor, 2 me gradë shkencore dhe 2 master).

Instituti i Studimeve Evropiane (ISE) ka tre departamente: Departamenti i Legjislacionit dhe Institucioneve Evropiane (1 anëtar personel akademik të kategorisë Master); Departamenti i Politikave dhe Qeverisjes në Evropë (1 anëtar personel akademik të kategorisë Master); Departamenti i Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (1 anëtar personel akademik të kategorisë profesor).

Stafi akademik me kohë të plotë i UT-së përbëhet nga 140 Profesorë, 169 Profesorë asociuar, 292 Doktorë (PhD) dhe 139 lektorë me gradën shkencore Master i Shkencave (MSc). Ky kapital njerëzor i kualifikuar përbën dhe pikën më të fortë të Universitetit të Tiranës dhe garancinë për zbatimin me sukses të këtij Plani Strategjik të Kërkimit Shkencor në pesë vitet e ardhëshme (Për më shumë informacion në lidhje me përbërjen e stafit akademik me kohët të plotë sipas kategorive dhe sipas gjinisë shih Tabelën 1).



Tabela 1. Të dhënat mbi stafin akademik me kohë të plotë të UT-së (viti akademik 2017-2018)

UNIVERSITETI I TIRANËS	STAFI AKADEMIK SIPAS KATEGORIVE														
	TOTALI I STAFIT AKADEMIK TË UT-së DHE NJËSIVË TË TIJ KRYESORE			Kategoria "Profesor"						Doktor			Lektor (MSc)		
				Profesor			Profesor i asociuar								
Fakulteti/Instituti	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj
UNIVERSITETI I TIRANËS	740	478	262	140	66	74	169	118	51	292	202	90	139	92	47
Rektorati	2	0	2	1	0	1	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	169	103	66	36	17	19	36	20	16	53	37	16	44	29	15
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	138	103	35	19	11	8	24	18	6	71	54	17	24	20	4
Fakulteti i Ekonomisë	148	99	49	30	16	14	39	32	7	52	33	19	27	18	9
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	88	48	40	25	10	15	24	15	9	28	16	12	11	7	4
Fakulteti i Drejtësisë	75	46	29	16	9	7	23	14	9	31	21	10	5	2	3
Fakulteti i Shkencave Sociale	77	49	28	10	2	8	20	16	4	43	29	14	4	2	2
Instituti i Fizikës Bertanore të Zbatuar	16	13	3	3	1	2	3	3	0	8	7	1	2	2	0
Filiali UT Sarandë	13	9	4	0	0	0	0	0	0	5	5	0	8	4	4
Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve	13	6	7	0	0	0	0	0	0	1	0	1	12	6	6
Instituti i Studimeve Europiane	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
Instituti Konfuci	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1

UT-ja shquhet për aktivitetin e pasur kërkimor-shkencor. Kështu vetëm gjatë vitit akademik 2016-2017, njësitë bazë të Universitetit të Tiranës kanë botuar 17 monografi shkencore, mbi 100 artikuj shkencorë në revista kombëtare, mbi 280 artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare. Stafi akademik i UT-së ka referuar mbi 130 punime shkencore në konferenca kombëtare dhe mbi 400 punime shkencore në konferenca ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë vitit akademik 2016-2017 UT-ja ka qenë pjesëmarrëse

në 77 projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka nënshkruar kontrate përfituar nga 42 marrëveshje me universitete europiane në kuadër të programit Erasmus + KA1.



2. Misioni dhe Vizioni i UT-së

Misioni

Misioni i kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës, si një institucion publik, është të krijojë njohuri dhe zgjidhje të reja për çështjet globale për t'i shërbyer nevojave të shoqërisë në fushat e shkencave shoqërore dhe natyrore.

Universiteti i Tiranës ka për qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor në shërbim të lirisë e të larmisë së ideve për ndërtimin dhe fuqizimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqenies e të dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme e transparente.

Universiteti i Tiranës, garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare.

Universiteti i Tiranës zhvillon veprimtarinë e kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të detyrimeve me karakter integruar, apo në realizim të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Universiteti i Tiranës realizon kërkimin shkencor në bashkëpunim me institucionet vendase dhe nëpërmjet shkëmbimit ndërkombëtar të pedagogëve e të studentëve, në përmbushje të objektivave dhe të programeve të tij.

Universiteti i Tiranës anëtarësohet në organizma të përhershme, si dhe aktivizohet në organizma dhe veprimtari të përkohshme të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.

Universiteti i Tiranës në përputhje me misionin e kërkimit shkencor dhe në respektim të lirisë së individit, harton programe e projekte të veçanta sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurrin me këto projekte në planin kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor.

Universiteti i Tiranës në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, ka si mision të përgatisë shkencëtarë të rinj, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend.

Universiteti i Tiranës ofron mundësi të barabarta pa asnjë lloj diskriminimi.

Universiteti i Tiranës kontribuon në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare.



Nëpërmjet këtij plani strategjik, Universiteti i Tiranës, ka për qëllim:

- a) të veprojë si qendër arsimore dhe kërkimore udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor të vendit tonë;
- b) të synojë të krijojë dhe të mbështesë standardet më të larta në fushën e kërkimit shkencor;
- c) të vendosë kërkimin shkencor mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;
- d) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës;
- e) të bazohet mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve;
- f) të promovojë barazinë gjinore.

Vizioni

Universiteti i Tiranës, nëpërmjet këtij plani strategjik të kërkimit shkencor, synon të shndërrohet në lider të kërkimit shkencor, duke mundësuar përfitimin e shoqërisë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë periudhës së këtij plani strategjik, duke u mbështetur në traditat afatgjata të Universitetit në lidhje me lirinë dhe autonominë akademike, do të nxisim një kulturë kërkimore shkencore, në të cilën risia luan një rol të rëndësishëm.

Gjithashtu, Universiteti i Tiranës synon të zhvillojë aftësinë për të shpërndarë njohuritë/rezultatet e kërkimit shkencor në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke siguruar kontribute të rëndësishme në politik-bërje dhe/ose rritjen ekonomike si dhe duke kontribuar në mënyrë efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike të shoqërisë.

Arritja e këtij vizioni të kërkimit shkencor në Universitetit të Tiranës, kërkon realizimin e objektivave të mëposhtme:

Rankimi/Renditja

Të rrisë nivelin e renditjes në listën e universiteve publike e private.

Bashkëpunimi

Të maksimizojë bashkëpunimin ndër disiplinor rreth çështjeve në zhvillim me rëndësi kombëtare, rajonale e ndërkombëtare ndërmjet strukturave publike dhe jo publike, me instrumenta rajonalë e ndërkombëtarë.

Ndikimi:

Të maksimizojë ndikimin e kërkimit në produkte që ndikojnë dhe ndryshojnë jetën e komunitetit si dhe në zhvillimin ekonomik - social kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Vizibiliteti/Njohja

Të kryejë kërkime të nivelit të lartë duke sjellë risi dhe duke bërë të mundur njohjen e universitetit përmes këtyre kërkimeve dhe risive.

Publikimi

Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatin/produktin e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave shkencore si dhe informimi i publikut.



3. Parimet mbi të cilat është i mbështetur Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor (PSKSH) në UT

Plani strategjik i kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës mbështetet në disa parime të gjithëpranuara dhe qartësisht të shprehura në Kartën Europiane të Kërkimit Shkencor (KEKSH):

Parimi i lirisë së kërkimit

Kërkuesit shkencorë duhet ta orientojnë punën e tyre për të mirën e njerëzimit dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive shkencore, ndërsa gëzojnë lirinë e mendimit dhe të shprehjes si edhe lirinë e identifikimit të metodave me anë të të cilave zgjidhen problemet, sipas praktikave dhe parimeve etike të njohura. Megjithatë, duhet që kërkuesit të njohin edhe kufizimet e kësaj lirie, të cilat mund të lindin si pasojë e rrethanave të veçanta të veprimtarisë kërkimore (përfshirë mbikëqyrjen/udhëheqjen/drejtimin) ose kufizimet operacionale, p.sh. për arsye buxhetore ose infrastrukturore ose, sidomos në sektorin industrial, për arsye të mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Megjithatë, nuk duhet që kufizime të tilla të bien ndesh me praktikën dhe parimet e njohura etike, të cilave kërkuesit shkencorë duhet t'iu përmbahen.

Parimi i etikës kërkimore

Kërkuesit shkencorë duhet t'iu përmbahen parimeve etike ndërkombëtare dhe kombëtare, si edhe parimeve të gjithëpranuara të disiplinave përkatëse ku ata kryejnë kërkimet e tyre.

Parimi i përgjegjshmërisë profesionale

Kërkuesit shkencorë duhet të angazhohen të kryejnë kërkime në fusha që sjellin doli në shoqëri, nuk përsërisin kërkime të kryera më parë, nuk përmbajnë asnjë formë plagjiazmi si edhe nuk shkelin rregullat e pronësisë intelektuale apo pronësisë së përbashkët të të dhënave.



Në rastet kur një pjesë e caktuar e kërkimit shkencor i delegohet një individ, kërkuesi duhet të garantojnë që individi në fjalë gëzon kompetencën shkencore për ta kryer atë, si edhe që individi do t'i përmbahet rregullave të sipërpërmendura.

Parimi i qëndrimit profesional

Kërkuesit shkencorë duhet t'i njohin qëllimet strategjike që rregullojnë mjedisin e tyre të kërkimit dhe mekanizmat e financimit dhe duhet të kërkojnë të gjitha miratimet e nevojshme përpara se të nisin kërkimin apo të aksesojnë burimet e dhëna. Ata duhet t'i informojnë punëdhënësit, drejtuesit ose mbikëqyrësit kur projekti i tyre kërkimor shtyhet në kohë, ripërcaktohet ose përfundon, ose të njoftojnë në rast se ai përfundon më herët apo nëse pezullohet për çdo lloj arsyeje.

Parimi i detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktuale

Kërkuesit shkencorë në të gjitha nivelet duhet të familjarizohen me rregullat kombëtare, sektoriale ose institucionale që rregullojnë trajnimin dhe/ose kushtet e punës. Këtu përfshihen të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe kërkesat dhe kushtet e çdo sponsori apo financuesi, pavarësisht nga natyra e kontratës së tyre. Kërkuesit duhet të veprojnë në përputhje me rregulloret të tilla duke dhënë rezultatet e dëshiruara (për shembull, tezë, publikime, patenta, raporte, zhvillim i produkteve të reja, etj) ashtu siç parashikohen në kushtet dhe afatet e kontratës apo të dokumentit ekuivalent.

Parimi i llogaridhënies/Përgjegjësia financiare

Kërkuesit shkencorë duhet të jenë të vetëdijshëm se janë të përgjegjshëm përpara punëdhënësve të tyre, financuesve apo organizmave të tjera publike ose private si edhe, në një masë më të madhe në planin etik, drejt shoqërisë si një e tërë. Në veçanti, kërkuesit e financuar nga fondet publike janë gjithashtu përgjegjës për përdorimin me efikasitet të parave të taksapaguesve. Për pasojë, ata duhet të veprojnë në përputhje me parimet e një menaxhimi financiar të duhur, transparent dhe efikas si edhe të bashkëpunojnë me çdo auditim të autorizuar të kërkimit të tyre, qoftë ky i kryer nga punëdhënësit/financuesit ose nga komitetet etike. Metodat e mbledhjes dhe analizës, rezultatet dhe, kur është me vend, hollësitë e të dhënave duhet të jenë të hapura për shqyrtim të brendshëm dhe të jashtëm, sa herë është e nevojshme dhe siç kërkohet nga autoritetet e duhura.



Parimi i praktikave të mira dhe sigurisë

Kërkuesit duhet të përdorin dhe të ushtrojnë praktika dhe teknika të sigurta gjatë kërkimit të tyre. Këto praktika duhet të jenë gjithmonë në përputhje të plote me të gjitha dispozitat ligjore të vendit, përfshirë këtu edhe praktikën për rikuperimin nga katastrofat e teknologjisë së informacionit për shëmbull, duke përgatitur strategji mbështetëse. Ata duhet gjithashtu të jenë të familjarizuar me kërkesat ligjore aktuale kombëtare në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe me kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të marrin të gjitha masat për t'i përmbushur ato në çdo kohë.

Parimi i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të rezultateve kërkimore

Të gjithë kërkuesit duhet të garantojnë që, në përputhje me kushtet e kontratave përkatëse të nënshkuara prej tyre, rezultatet e kërkimeve të tyre shkencore të bëhen të njohura, të shpërndahen dhe të shfrytëzohen nga të gjithë individët e interesuar dhe nga publiku i gjerë.

Parimi i marrëdhënieve me mbikqyrësit

Kërkuesit në fazën e tyre të trajnimit duhet të vendosin një marrëdhënie të strukturuar dhe të rregullt me mbikqyrësin/mbikqyrësit e tyre dhe me përfaqësuesin (it) e fakultetit/departamentit në mënyrë që të përfitojnë sa më mirë nga marrëdhënia me ta. Këtu përfshihet mbajtja e të dhënave për të gjithë ecurinë e punës dhe gjetjet e kërkimit, marrja e përshtypjeve me anë të raporteve dhe seminareve, përdorimi i këtyre përshtypjeve dhe puna në përputhje me kalendarin, afatet, rezultatet e pritshme dhe/ose rezultatet e kërkimit, siç janë miratuar më parë.

Parimi i mbikqyrjes dhe detyrimeve drejtuese

Kërkuesit me përvojë duhet t'i kushtojnë vëmendje dhe kohë edhe funksioneve të tyre të tjera, të cilat mund të jenë udhëheqës shkencor, drejtues apo koordinator projekti, këshillues karricre, etj. Ata duhet t'i përmbushin këto detyrime me standarde të larta profesionale. Në lidhje me rolin e tyre si mbikqyrës ose udhëheqës të kërkuesve, kërkuesit e vjetër duhet që të ndërtojnë një marrëdhënie konstruktive dhe pozitive me kërkuesit në fazat e para, në mënyrë që të vendosin kushtet për transferimin e njohurive dhe për një zhvillim të mëtejshëm e të suksesshëm të karricrës së kërkuesve.

Parimi i përmirësimit të vijueshëm profesional

Kërkuesit, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të karricrës, duhet të kërkojnë të përmirësojnë dhe të përditësojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre profesionale.

Për më shumë informacion në lidhje me parimet e Kartës Europiane të Kërkimit vizitoni:

http://www.akti.gov.al/.../KartaEuropiane_KodiSjelljesRekrutimin_Kerku



4. Qëllimi i hartimit të PSKSH-së

Parimet e Kartës Europiane për kërkuesit dhe Kodi i Sjelljes për rekrutimin e kërkuesve, të hartuar nga Komisioni European në 2005, ligji Nr.80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë si dhe Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin-SKKSHTI (për periudhën 2017-2022) në Republikën e Shqipërisë shtojnë përpara universiteteve dhe institucioneve akademike në vend nevojën për të rishikuar dhe zhvilluar planet e tyre strategjike në zbatim të këtyre dokumentave.

Universiteti i Tiranës, me këtë PSKSH dëshmon përgjegjësinë e tij për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes ofrimit të produkteve shkencore dhe shërbimeve në dobi të tij, mirëqënies së shoqërisë dhe ruajtjes së pasurive natyrore dhe kulturore.

Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor të UT-së shërben si një udhëzues për vendimarrjen lidhur me iniciativat institucionale, shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore sipas prioriteve të zhvillimit të institucionit. UT njeh si kyç të suksesit në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të kërkimit shkencor stafin akademik, studentët (e të tre cikleve të studimit), si dhe personelin ndihmës akademik dhe administrativ. Ne çmojmë krijimtarinë e kërkuesve dhe do të vazhdojmë të krijojmë një mjedis që frymëzon imagjinatën, zgjuarsinë dhe produktivitetin e kërkuesve tanë.

5. Objektivat kryesorë të kërkimit shkencor në Universitetin e Tiranës

Ky plan mbështetet në 5 shtylla kryesore (synime strategjike), të cilat janë të lidhura ngushtësisht me forcimin e cilësisë së kërkimit shkencor në UT, të njohur kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht, me cilësinë dhe impaktin e tij, si dhe orientimin drejt nevojave të vendit për zhvillim. Këto pesë shtylla apo synime strategjike janë:

1. Rekrutimi cilësor dhe zhvillimi i karrierës mbi bazën e meritës dhe konkurrencës: "Të synojmë ekselencën!"
2. Rritja e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor
3. Hapja e universitetit drejt tregut dhe përgjigja ndaj nevojave të vendit
4. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

5. Etikë dhe integritet i lartë profesional i kërkuesve të UT-së

Për arritjen e këtyre synimeve strategjike të kërkimit shkencor do të punohet shumë dhe sistematikisht për përmbushjen e këtyre Objektivave kryesorë:



Objektivi 1. Forcimi i kapaciteteve dhe i cilësisë së kërkimit shkencor në UT, investojmë më shumë për kapitalin njerëzor!;

Objektivi 2. Forcimi i trajnimit të kërkuesve shkencorë, duke u siguruar atyre një mjedis kërkimor stimulues të fokusuar në ekselencë: UT të jetë lider në sistemin universitar shqiptar për integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien!;

Objektivi 3. Sigurimi i aksesit të kërkuesve shkencorë në burime dhe infrastrukturë shkencore funksionale, përmes një menaxhimi të përshtatshëm të infrastrukturës ekzistuese dhe të asaj të krijuar rishtas, dhe që garanton përdorimin e saj në mënyrë sa më efektive;

Objektivi 4. Zhvillimi i marrëdhënieve të reja të kërkimit shkencor me industrinë, bizneset dhe institucionet e tjera akademike dhe universitare në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;

Objektivi 5. Përmirësimi i aksesit në rezultatet e kërkimit shkencor të kërkuesve të UT-së përmes shtimit të botimeve, transferimit dhe aplikimit të dijes, me qëllim që të maksimizojmë përfitimet prej saj në shoqëri dhe mjedis;

Objektivi 6. Integrim më i mirë i UT-së në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (HEK/ERA), duke rritur performancën dhe pjesëmarrjen e UT-se në projektet dhe programet evropiane të kërkimit shkencor.

6. Plani i veprimit

Arritja e objektivave të mësipërm strategjik të kërkimit shkencor në UT do të kërkojë ndërmarrjen e një sërë masash dhe aksionesh/veprimesh, të cilat në lidhura organikisht me objektivat e lartpërmendura dhe në bashkveprimin dhe lidhjen e ndërsjelltë midis tyre, janë një garanci për arritjen e synimeve strategjike në fushën e kërkimit shkencor brenda UT-së. Më poshtë në mënyrë të përmbledhur janë renditur aksionet dhe rezultatet e pritëshme për secilin prej 6 objektivave të PSKSH-së.

Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve dhe i cilësisë së punës kërkimore të UT-së

Forcimi i kapaciteteve kërkimore përfshin si investimin për kapitalin njerëzor (kërkuesit), ashtu edhe rritjen e burimeve të financimit në mbështetje të kërkimit shkencor. Në kuadrin e kësaj strategjie, Universiteti i Tiranës do të ndër marrë një sërë aksionesh që synojnë një rekrutim dhe vlerësim objektiv e të shëndetshëm të kërkuesve shkencorë, rritjen e fondeve të mobilitetit për kërkim për studentët doktoraturës dhe stafin akademik, hartimin e kriterëve vlerësues të kërkimit shkencor, sigurimin e një karriere të suksesshme kërkimore për stafin akademik, përmirësimin e kushteve të punës dhe të sigurisë sociale, implementimin e një politike të barazisë gjinore në kërkimin shkencor, implementimin e një politike që adreson punonjësit me aftësi të kufizuara, përfshirjen e mësimdhënies si pjesë esenciale e vlerësimit të punës së përditshme të stafit akademik, krijimin e një mjedisi kërkimor sa më tërheqës për kërkuesit e rinj, si edhe përfshirjen e kërkuesve në vendimmarrje.

Kërkuesit nuk mund të jenë ekselentë në çdo gjë, por grupet e kërkuesëve mund të jenë të tillë përmes kombinimit të pikave të forta të anëtarëve të grupit kërkimor. Universiteti i Tiranës dëshiron të njohë dhe inkurajojë performancën e lartë në kërkim dhe mësimdhënie, si dhe në shërbime për shoqërinë. Ndonëse, kërkimi i cilësisë së lartë është baza për një mësimdhënie dhe shërbime të tjera cilësore, vlerësimi i stafit akademik nuk duhet të fokusohet vetëm në kërkim. Universiteti i Tiranës dëshiron të mbajë parasysh parimet e mëposhtme në vlerësimin e kërkuesëve:

- Standardet e vlerësimit duhet të jenë ndërkombëtare dhe ambicioze.
- Standardet e vlerësimit duhet të jenë të drejta, objektive dhe të përshtatshme.
- Kriteret e vlerësimit duhet të njohin eksperiencën kërkimore ndërsektoriale dhe ndërkombëtare.
- Vlerësimi duhet të lehtësohet përmes një sistemi informimi efektiv për kërkimin shkencor.
- Kriteret e vlerësimit për kërkimin shkencor duhet të përputhen me përshkrimin e detyrave të stafit akademik, dhe të jenë në barazpeshë me kriteret për detyra të tjera si: mësimdhënia dhe shërbimet për shoqërinë.

Aksionet/Rezultatet e pritëshme

1.1 Ngritja e një rregulloreje/procedure cilësore pranimi/rekrutimi dhe procesi mbikëqyrjeje për të gjithë kërkuesit me doktoraturë, bazuar në kodin e sjelljes së BE-së për Rekrutimin e Kërkuesve shkencorë.

1.2 Përgatitja e një portali për kërkim online të pozicioneve të punës, brenda UT-së, me qëllim rekrutimin e kandidatëve sa më cilësorë. Ky portal/website duhet përkthyer në Anglisht. Po kështu njoftimet për vende të reja pune duhet të publikohen në "EURAXESS Jobs". Njoftimi për vende të reja pune duhet të zgjatet më shumë se 15 ditë.



1.3. Rritja e kapaciteteve të Qendrave të Zhvillimi të Karrierës (QZHK) në fakultete për t'u marrë me kërkuesit, së paku kandidatët për doktoraturë, duke ofruar trainime për stafin e QZHK-ve.

1.4 Rekrutimi i studentëve që ndjekin studimet post-doktorale dhe studiuesve të shquar shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, përmes shfrytëzimit më të mirë të përfitimeve nga fondet e mobiliteteve për kërkim.

1.5 Zbatimi i një skeme për mbështetje mobiliteti për kërkuesit në nivel fakulteti sipas një udhëzuesi të ri mbi bazën e një studimi paraprak.

1.6 Kryerja e një studimi leverdisëshmerie për të nxitur një sistem institucional sabbatik për stafin profesoral dhe të vepruarit në përputhje me rekomandimet e këtij studimi.

1.7 Garantimi i informacionit të përshtatshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm lidhur me punësimin në njësitë kryesore dhe bazë të UT.

1.8 Hartimi i një udhëzuesi të praktikës së mirë (Good Practice) për vlerësimin e performancës individuale kërkimore, sipas kriterëve të mirëpërcaktuara.

1.9 Ngritja e një sistemi të individualizuar të performancës për profesoratin dhe dhënia e rekomandimeve që dalin prej tij.

1.10 Ngritja e një sistemi solid të informacionit për kërkimin shkencor, si pjesë e sistemit të informacionit të UT.

1.11 Hartimi i një strategjie të integruar për zhvillimin e karrierës dhe përgatitja e udhëzuesit për kërkuesit në të gjitha stadet e karrierës së tyre.

1.12 Krijimi nga ana e departamenteve e të gjitha mundësive që kërkuesit e rinj dhe drejtuesit e tyre të zhvillojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre kërkimore.

1.13 Hartimi dhe zbatimi i një plani për sigurimin e barazisë gjinore të kapitalit njerëzor të kërkimit shkencor (të garantohet përfshirja e të paktën 40% të gjinisë më pak të përfaqësuar në njësitë e kërkimit shkencor; aktualisht jemi në raportin 65% femra dhe 35% meshkuj).

1.14 Hartimi dhe zbatimi i një plani veprimi për mbrojtjen e personelit akademik me aftësi të kufizuara, për të siguruar cilësi pune dhe pjesëmarrje të njëjtë të tyre në kërkim, duke reduktuar pengesat e mundshme që ata hasin.

1.15 Njohja e plotë e mësimdhënies në sistemin e vlerësimit të kërkuesit shkencor (Stafi akademik me gradën "Doktor" dhe që ka kryer studime post-doktorale duhet të ketë përgjegjësi mësimdhënieje substanciale për t'u konsideruar zyrtarisht si bashkë-lektor).



1.16 Njohja e plotë e përgjegjësive manaxheriale të kërkimit për kërkuesit që kanë kryer studime post-doktorale, përfshi këtu menaxhimin buxheti dhe mbikëqyrës për studentët e doktoraturës.

1.17 Programet e trajnimit të doktoraturës duhet të përfshijnë sesione mbi integritetin shkencor dhe përgjegjësinë profesionale të kërkuesëve.

1.18 Hartimi i një politike "Open Data" për aksesin ndaj të dhënave të kërkimit shkencor, duke përfshirë krijimin e një strukture dixhitale për depozitimin, ruajtjen, përpunimin dhe aksesin në këto të dhëna.

1.19 Fuqizimi i infrastrukturës kërkimore brenda njësive kryesore dhe njësive bazë të UT-së, duke rritur mbështetjen financiare për blerje, mirëmbajtje dhe riparime të pajisjeve.

1.20 Përpyetje për përmirësimin e kuadrit ligjor rregullator mbi menaxhimin financiar dhe prokurimin për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, në mbështetje të autonomisë dhe lirisë akademike.

1.21 Ngritja e një sistemi për të hetuar dhe parandaluar plagjaturën në çdo njësi kryesore të UT-së dhe rritja e kapaciteteve dhe funksionimit të Komitetit të Etikës (KE) në UT dhe njësitë kryesore.

Objektivi 2. Trajnimi i kërkuesve shkencorë

Zhvillimi i talentit dhe ekselencës për të gjitha kategoritë e stafëve, është një prej synimeve strategjive kryesore të Univeritetit të Tiranës. Kërkuesit e UT-së duhet të kenë akses në trajnime të cilësisë së lartë. Kjo është pjesë e vizionit institucional të zhvillimit të një komuniteti kreativ të punonjësve të dijes që janë të mirëpajisur e aftësuar për një botë e cila ndryshon shpejt dhe vazhdimisht. Universiteti i Tiranës do të jetë i angazhuar me komunitetin e kërkuesëve dhe do të stimulojë krijimin e një baze solide për një mentalitet "të mësuar gjatë gjithë jetës" tek i gjithë stafi akademik. UT-ja do të investojë në fuqizimin e kërkuesëve me gradë shkencore dhe studime post-doktorale, përmes forcimit të vetëdijes për mundësitë e gjithanshme që ata kanë për të zhvilluar karrierën e tyre brenda dhe jashtë institucioneve akademike.

Programet e trajnimit dhe zhvillimit të karrierës për kategoritë e ndryshme të kërkuesëve do të ishin:

1. Për kërkuesit me gradë "Doktor" dhe ata që kanë ndjekur studime "Post-doktorale", programi i trajnimit i ofruar nga specialistët e nivelit të lartë do të përfshinte këto tema:

- Menaxhimi i karrierës





- Komunikim
- Aftësitë drejtuese dhe efienca personale
- Kërkimi dhe vlerësimi i performancës
- Kreativiteti, pozitiviteti dhe aftësia përshtatëse

2. Për profesoratin programi i trainimit do të përfshinte:

- Aftësitë drejtuese dhe mbikëqyrja
- Menaxhimi i grupeve të kërkimit
- Menaxhimi i departamentit
- Menaxhimi i konflikteve brenda stafit akademik

Aksionet/Rezultatet e pritëshme

2.1 Zhvillimi i një modeli të integruar dhe të qëndrueshëm të zhvillimit të karrierës për studentët e doktoraturës, ata që kanë ndjekur studime post-doktorale dhe profesoratin.

2.2 Hartimi dhe zbatimi i një programi cilësor trainimi për të gjitha kategoritë e personelit akademik (doktorantët, post-doktorantët dhe profesoratin) sipas temave të lartpërmendura.

2.3 Organizimi i trainimeve për mbrojtjen e rezultateve të kërkimit shkencor, e konfidencialitetit të tyre para publikimit, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale të grumbulluara gjatë procesit të kërkimit.

2.4 Ngritja dhe zbatimi i procedurave të vlerësimit të aktiviteteve të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes.

2.5 Ngritja e një sistemi të "kontratës" me studentët e doktoraturës, duke e vënë theksin në mbrojtjen e së drejtës së autorësisë mbi materialet dhe produktin shkencor.

2.6 Zbatimi i strategjive të reja të financimit të kërkimit shkencor të UT-së që do t'i mundësojnë institucionit të rrisë numrin e kërkuesve dhe studentëve që merren me kërkim shkencor si dhe bashkëpunimin mes tyre.

2.7 Inkurajimi dhe drejtimi i studentëve të të tre cikleve të shkollimit për të shpërndarë rezultatet e kërkimit të tyre, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i aftësive të tyre për kërkim dhe transferim njohurish.

2.8 Njësitë kryesore (Fakultetet, Institutet) të rrisin kapacitetet e tyre menaxhuese për grupet kërkimore me qëllim që të menaxhojnë sa më efektivisht punën mbikëqyrëse mbi masterat shkencorë, doktoraturat dhe projektet me bashkëpunim të gjerë.

Objektivi 3. Menaxhimi dhe përmirësimi i burimeve dhe infrastrukturës së kërkimit shkencor

Për të mbështetur dhe promovuar kërkimin shkencor në UT, ne duhet të mësojmë programet e mbështetjes (administrative dhe financiare), infrastrukturën shkencore punën në terren dhe pajisjet në mënyrë inovatore, që të ofrojmë shërbimin dhe aksesin më të shpejtë për stafin akademik dhe studentët.



Aksionet/Rezultatet e pritëshme

3.1 Mbështetja dhe përmirësimi i infrastrukturës shkencore brenda njësive kryesore dhe njësive bazë të UT-së (laboratorët shkencore të analizës në biologji, bioteknologji, kimi, fizikë, informatikë, matematikë e aplikuar, kontabilitet).

3.2 Menaxhimi efektiv dhe inovator i njësive mbështetëse të kërkimit shkencor (njësive administrative dhe financiare, bibliotekave, etj) për të siguruar shërbime më të mira dhe akses për stafet akademike dhe studentët. E-learning mund të jetë një mundësi e mirë për trajnimin e vazhdueshëm të tyre si një mënyrë inovative e të mësuarit dhe të ndarit të eksperiencave në ambjentet akademike.

